REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA FUSHË KOSOVË - OPŠTINA KOSOVO POLJE
Drejtorati për Administratë
Direkcija za Administraciju
Nr.Br. 32 dt. 27-02 2015
FUSHË KOSOVË - KOSOVO POLJE

**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA**
**REPUBLIC OF KOSOVA**

**KOMUNA E FUSHË–KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE**
**MUNICIPALI TY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE**

**Datë: 26.02.2015**

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 26.02.2015, pas shqyrtimit të Kërkesës Nr. 130 të datës 12.02.2015, të paraqitur nga CARITAS KOSOVA, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në Nenin 40, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008) dhe Nenin 27, të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

# V E N D I M

1. Aprovohet Kërkesa Nr. 130 e datës 12.02.2015, për bashkëpunimin dhe bashkë - financimin në realizimin e projektit 'Ngritja e përkujdesit social dhe shëndetësor në komunën e Fushë-Kosovës'.

2. Me realizimin e projektit ndihmohen qytetarët e komunës së Fushë-Kosovës në ofrimin e shërbimeve për përmirësimin e kushteve të jetesës:

2.1 Shërbime sociale edukative dhe shëndetësore për përmirësimin e kushteve të varfërisë për shtresat sociale;
2.2 Punësimin e mbi 60 qytetarëve të komunës në veprimtari të ndryshme sociale dhe edukative;
2.3 Parandalimin e procesit të migrimit ilegal të qytetarëve, me krijimin e vendeve të reja të punës.

3. Për realizimin e projektit sipas pikës një (1) të vendimit, obligohet Kryetari i Komunës që të lidhë marrëveshje me CARITAS KOSOVA për bashkëpunim dhe financim në realizimin e projektit.

4. Ky vendim hyn në fuqi, ditën e aprovimit, nga Kuvendi i Komunës.

**Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, CARITAS KOSOVA, Drejtorisë për FB, Drejtorisë për SHMS, Drejtorisë për ARSIM dhe Arkivës.**

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**
**Mr. Fadil Krasniqi**

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA FUSHË KOSOVË - OPŠTINA KOSOVO POLJE
Kuvendi i Komunës - Skupština Opštine

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA FUSHË KOSOVË - OPŠTINA KOSOVO POLJE
Drejtorati për Administratë
Direkcija za Administraciju
Nr.Br. 34 dt. 03.03 2015
FUSHË KOSOVË - KOSOVO POLJE

**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA**
**REPUBLIC OF KOSOVA**

**KOMUNA E FUSHË–KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE**
**MUNICIPALI TY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE**

**Datë: 03.03.2015**

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 26.02.2015, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 55, të datës 03.02.2015, paraqitur nga Drejtoria për Financa dhe Buxhet, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në Nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (b dhe c), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), Nenin 8 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal Nr. 03/L-049, (Gazeta Zyrtare Nr. 27/2008), Nenin 27, shkronja (c dhe ç) dhe Nenin 54 të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

VENDIM

1. Lejohet bartja e të hyrave vetjake nga viti 2014 në vitin 2015 në shumë të përgjithshme prej 859,859.39€, nga fondi burimor 21 dhe 22, sipas buxhetit të aprovuar për vitin 2014.

2. Ridestinimi i të hyrave vetjake nga fondi burimor 21 dhe 22 lejohet si vijon:

| Fond Buri | Org Buxh | Kodi i Prog | Programi | Kat Eko | Përshkrimi i Kat.Eko.Proj | Kodi i Proj | Shuma në 2014 | Shuma në 2015 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 21 | 612 | 16002 | Zyra e Kryetarit të Komunës | 200 | Subvencione e transfere | | 0.72 | 0.72 |
| 21 | 612 | 17502 | Buxhet | 200 | Subvencione e transfere | | 1.48 | 21.32 |
| 21 | 612 | 17502 | Buxhet | 300 | Bashkëfinancimi i projekteve | 89168 | 88,629.25 | 88,629.25 |
| 21 | 612 | 17502 | Buxhet | 300 | Blerja e fotokopjeve | 89173 | 8,793.00 | 9,059.00 |
| 21 | 612 | 18162 | Inf. Publike | 130 | Mallra dhe shërbime | | 111,153.22 | 111,154.47 |
| 21 | 612 | 18162 | Inf. Publike | 300 | Mir.Inf.Rrug - ore, Kanalizmeve | 89174 | 10,553.80 | 10,553.80 |
| 21 | 612 | 18162 | Inf. Publike | 300 | Blerja e kontejnerëve | 89175 | 11.46 | 11.46 |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 21 | 612 | 18162 | Inf. Publike | 300 | Pastrimi i ambientit | 89176 | 6,997.12 | 9,956.29 |
| 21 | 612 | 18162 | Inf. Publike | 300 | Ndërtimi i Parqeve dhe Trotuareve | 89177 | 1,378.25 | 1,378.25 |
| 21 | 612 | 18162 | Inf. Publike | 300 | Rastet Emergjente | 89178 | 20.00 | 20.00 |
| 21 | 612 | 18162 | Inf. Publike | 300 | Vendosja e Ndriçimit dhe Mirëmbajtja | 89179 | 44,010.00 | 44,010.00 |
| 21 | 612 | 18162 | Inf. Publike | 300 | Mirëmbajtja e Ndriçimit | 89181 | 557,10 | 557.10 |
| 21 | 612 | 18162 | Inf. Publike | 300 | Shtruarja e e rrugëve terciare me zhavorr | 89188 | 10,112.35 | 10,112.35 |
| 21 | 612 | 47042 | Bujqësia | 200 | Subvencione e transfere | | 5,839.30 | 5,842.29 |
| 21 | 612 | 66015 | Urbanizëm | 300 | Asfaltimi në Graboc të Poshtëm | 89194 | 20,000.00 | 20,000.00 |
| 21 | 612 | 66015 | Urbanizëm | 300 | Asfaltimi në Bardh të Madh | 89195 | 35,000.00 | 35,000.00 |
| 21 | 612 | 66015 | Urbanizëm | 300 | Asfaltimi në Bardh të Vogël | 89196 | 10,000.00 | 10,000.00 |
| 21 | 612 | 66015 | Urbanizëm | 300 | Asfaltimi në Sllatinë të Madhe | 89197 | 30,000.00 | 30,000.00 |
| 21 | 612 | 66015 | Urbanizëm | 300 | Asfaltimi në Vragoli | 89198 | 20,000.00 | 20,000.00 |
| 21 | 612 | 66015 | Urbanizëm | 300 | Asfaltimi në Miradi të Epërme | 89199 | 25,000.00 | 25,000.00 |
| 21 | 612 | 66015 | Urbanizëm | 300 | Asfaltimi në Nakarad | 89200 | 25,000.00 | 25,000.00 |
| 21 | 612 | 66015 | Urbanizëm | 300 | Asfaltimi në Harilaç | 89201 | 20,000.00 | 20,000.00 |
| 21 | 612 | 66015 | Urbanizëm | 300 | Asfaltimi në Henc | 89202 | 10,000.00 | 10,000.00 |
| 21 | 612 | 66015 | Urbanizëm | 300 | Asfaltimi në Lismir | 89203 | 20,000.00 | 20,000.00 |
| 21 | 612 | 66015 | Urbanizëm | 300 | Asfaltimi në Miradi e Poshtme | 89204 | 25,000.00 | 25,000.00 |
| 21 | 612 | 66015 | Urbanizëm | 300 | Asfaltimi në rrugën Pomozotin/Kuzmin | 89205 | 24,858.00 | 24,858.00 |
| 21 | 612 | 66015 | Urbanizëm | 300 | Ndërtimi i Rrjeteve të Kanalizimeve dhe Ujësjellësve | 89206 | 12,674.96 | 12,674.96 |
| 21 | 612 | 73011 | Administrata e shëndetësisë | 130 | Mallra e shërbime | | 15,033.88 | 15,039.42 |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 21 | 612 | 73011 | Administrata e shëndetësisë | 200 | Subvencione e transfere | | 20,400.00 | 20,400.00 |
| 21 | 612 | 73011 | Administrata e shëndetësisë | 300 | Blerja e pajisjeve për shëndetësi | 89207 | 2,029.00 | 2,029.00 |
| 21 | 612 | 73011 | Administrata e shëndetësisë | 300 | Ndërtimi i shtëpive për raste sociale | 89210 | 5,280.00 | 5,280.00 |
| 21 | 612 | 73011 | Administrata e shëndetësisë | 300 | Ndërtimi i ambulancës në Fushë-Kosovë | 89211 | 19,735.56 | 19,735.56 |
| 21 | 612 | 73150 | Kujdesi Primar Shëndetësor | 111 | Paga dhe mëditje | | 8,811.09 | 8,811.10 |
| 21 | 612 | 85002 | Kulturë Rini dhe Sport | 200 | Subvencione e transfere | | 9,266.00 | 9,293.46 |
| 21 | 612 | 92010 | Administrata e arsimit | 300 | Blerja e inventarit | 89220 | 30.00 | 30.00 |
| 21 | 612 | 92010 | Administrata e arsimit | 300 | Ndërtimi i shkollës në fshatin Pomozotin | 89222 | 68,019.78 | 68,019.78 |
| 21 | 612 | 92010 | Administrata e arsimit | 300 | Ndërtimi i shkollës në Nakarad | 89223 | 50,000.00 | 50,000.00 |
| 21 | 612 | 92010 | Administrata e arsimit | 200 | Subvencione e transfere | | 20,000.00 | 20,000.00 |
| 21 | 612 | 92010 | Administrata e arsimit | 130 | Mallra e shërbime | | 15,000.00 | 15,000.00 |
| 22 | 612 | 16002 | Zyra e Kryetarit të Komunës | 130 | Mallra e shërbime | | 35.47 | 35.47 |
| 22 | 612 | 16302 | Administrata | 130 | Mallra e shërbime | | 159.28 | 159.28 |
| 22 | 612 | 16603 | Inspeksioni | 130 | Mallra e shërbime | | 4.92 | 4.92 |
| 22 | 612 | 17502 | Buxhet | 130 | Mallra e shërbime | | 8.47 | 8.47 |
| 22 | 612 | 17502 | Buxhet | 200 | Subvencione e transfere | | 19.84 | 0.00 |
| 22 | 612 | 17502 | Buxhet | 300 | Blerja e mobilieve | 87145 | 4,725.36 | 4,725.36 |
| 22 | 612 | 17502 | Buxhet | 300 | Blerja e automjeteve | 87146 | 5,000.00 | 5,000.00 |
| 22 | 612 | 17502 | Buxhet | 300 | Blerja e fotokopjeve | 87147 | 266.00 | 0.00 |
| 22 | 612 | 18162 | Inf.Publike | 130 | Mallra e shërbime | | 1.25 | 0.00 |
| 22 | 612 | 18162 | Inf.Publike | 300 | Pastrimi i ambientit | 87152 | 2,959.17 | 0.00 |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 22 | 612 | 18162 | Inf. Publike | 300 | Ndërtimi i trotuareve në fshatin Sllatinë e Madhe | 87158 | 10,000.00 | 10,000.00 |
| 22 | 612 | 47042 | Bujqësia | 130 | Mallra e shërbime | | 109.32 | 109.32 |
| 22 | 612 | 47042 | Bujqësia | 200 | Subvencione e transfere | | 2.99 | 0.00 |
| 22 | 612 | 66015 | Urbanizëm | 130 | Mallra e shërbime | | 3.23 | 3.23 |
| 22 | 612 | 66015 | Urbanizëm | 300 | Pastrimi i lumit „Drenicë" | 85111 | 44.58 | 44.58 |
| 22 | 612 | 73011 | Administrata e shëndetësisë | 130 | Mallra e shërbime | | 5.54 | 0.00 |
| 22 | 612 | 73011 | Administrata e shëndetësisë | 300 | Rregullimi i oborreve të ambulantave | 87179 | 25,000.00 | 25,000.00 |
| 22 | 612 | 73150 | Kujdesi Primar Shëndetësor | 111 | Paga dhe mëditje | | 0.01 | 0.00 |
| 22 | 612 | 85002 | Kulturë Rini dhe Sport | 130 | Mallra e shërbime | | 6.89 | 6.89 |
| 22 | 612 | 85002 | Kulturë Rini dhe Sport | 200 | Subvencione e transfere | | 27.46 | 0.00 |
| 22 | 612 | 85002 | Kulturë Rini dhe Sport | 300 | Gjurmime Arkeologjike | 87182 | 10,767.00 | 10,767.00 |
| 22 | 612 | 92010 | Administrata e arsimit | 130 | Mallra e shërbime | | 0.30 | 0.00 |
| 22 | 612 | 92010 | Administrata e arsimit | 300 | Rrethoja e shkollës në fshatin Bardh i Vogël | 84020 | 1,516.99 | 1,516.99 |
| Totali | | | | | | | 859,859.39 | 859,859.39 |

3. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për zbatimin e këtij vendimi është në kompetencë të Kryetarit të Komunës dhe Drejtorisë për Financa dhe Buxhet.

4. Ky vendim hyn në fuqi, ditën e aprovimit, nga Kuvendi i Komunës.

**Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorive të Komunës dhe Arkivës.**

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**
**Mr. Fadil Krasniqi**

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA FUSHË KOSOVË - OPŠTINA KOSOVO POLJE
Drejtorati për Administratë
Direkcija za Administraciju
Nr.Br. 36 dt. 05.03.2015
FUSHË KOSOVË - KOSOVO POLJE

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË–KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALI TY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE

Datë: 05.03.2015

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 26.02.2015, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 101, të datës 05.02.2015, paraqitur nga Kryetari i Komunës, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në Nenin 40, pika 40.2 shkronja (l), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), Nenin 27, shkronja (nj), Nenin 48, të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, Nenin 52, Nenin 55, të Rregullores për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Organeve të Administratës Komunale, Nr. 125. të datës 25.09.2014, Nenin 1, Nenin 6, paragrafi 2 dhe Nenin 9, paragrafi 1, pika 1.3, të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr. 83, datës 14.06.2013 mori:

# V E N D I M

1. Lejohen mjetet financiare, në shumë prej 30,000.00€, për Klubin e Futbollit "Fushë-Kosova", për t'iu ndihmuar në mbulimin e shpenzimeve për pjesëmarrjen në Kampionatin e Futbollit të Ligës së Parë të Kosovës në Futboll, për sezonin 2014-2015.

2. Është në kompetencë të Drejtorisë për Financa dhe Buxhet që të sigurojë mjetet financiare sipas pikës një (1) të vendimit.

3. Obligohet Klubi i Futbollit "Fushë-Kosova" që për mjetet e lejuara financiare, sipas pikës një (1) të vendimit, t'i raportojë me shkrim Kuvendit të Komunës.

4. Kryerja e procedurave tjera dhe mbikëqyrja e destinimit të mjeteve financiare është në kompetencë të Drejtorisë për Kulturë, Rini e Sport dhe Drejtorisë për Financa, Buxhet e Pronë.

5. Ky vendim hyn në fuqi, ditën e aprovimit, nga Kuvendi i Komunës.

**Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit, Drejtorisë për KRS, Drejtorisë për FB dhe Arkivës.**

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**
**Mr. Fadil Krasniqi**

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA FUSHË KOSOVË - OPŠTINA KOSOVO POLJE
Drejtorati për Administratë
Direkcija za Administraciju

Nr.Br. 37 dt. 05.03 2015
FUSHË KOSOVË - KOSOVO POLJE

**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA**
**REPUBLIC OF KOSOVA**

**KOMUNA E FUSHË–KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE**
**MUNICIPALI TY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE**

**Datë: 05.02.2015**

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 26.02.2015, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 871, të datës 17.12.2014, të paraqitur nga Kryetari i Komunës, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në Nenin 40, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), Nenin 11, paragrafi 1 të 'Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme', Nenin 27, të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

VENDIM

1. Aprovohet në parim propozimi Nr. 871, i datës 17.12.2014, për fillimin e procedurave për mundësinë e ndërrimit të Ngastrës Kadastrale, Nr. 767/13, në Zonën Kadastrale Fushë-Kosovë, me objektin aktual të privatizuar në funksion të Administratës së Komunës së Fushë-Kosovës, me pjesën e Ngastrës Kadastrale Nr. 1263-0, në Zonën Kadastrale Fushë-Kosovë, me objektin në ndërtim nga Komisioni Evropian.

2. Ky vendim hyn në fuqi, ditën e aprovimit, nga Kuvendi i Komunës.

**Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë për GJKP dhe Arkivës.**

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**
**Mr. Fadil Krasniqi**

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA FUSHË KOSOVË - OPŠTINA KOSOVO POLJE
Drejtorati për Administratë
Direkcija za Administraciju

Nr.Br. 38 dt. 05.03 2015
FUSHË KOSOVË - KOSOVO POLJE

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË–KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE

Datë: 05.03.2015

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 26.02.2015, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 100, të datës 05.02.2015, paraqitur nga Kryetari i Komunës, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në Nenin 40, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), Nenin 27, Nenin 48 të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, Nenin 57 të Rregullores për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Organeve të Administratës Komunale, Nr. 125. të datës 25.09.2014, Nenin 1, Nenin 6, paragrafi 2, të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr. 83, datës 14.06.2013, mori:

VENDIM

1. Lejohen mjetet financiare në shumë prej 40,000.00€ për Bashkësinë Islame dhe Bashkësinë Ortodokse në Fushë-Kosovë, për të ndihmuar qytetarët me vendbanim të përhershëm në territorin e komunës së Fushë-Kosovës, për mbulimin e shpenzimeve të varrimit.

2. Është në kompetencë të Drejtorisë për Financa dhe Buxhet që të sigurojë mjetet financiare sipas pikës një (1) të vendimit.

3. Obligohet Bashkësia Islame dhe Bashkësia Ortodokse në Fushë-Kosovë që për mjetet e lejuara financiare, sipas pikës një (1) të vendimit, t'i raportojë me shkrim Kuvendit të Komunës.

4. Kryerja e procedurave tjera dhe mbikëqyrja e destinimit të mjeteve financiare është në kompetencë të Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Mjedis, Drejtorisë për Financa dhe Buxhet.

5. Ky vendim hyn në fuqi, ditën e aprovimit, nga Kuvendi i Komunës.

**Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit, Drejtorisë për SHPM, Drejtorisë për FB dhe Arkivës.**

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**
**Mr. Fadil Krasniqi**